

Shkodër, më 11.03.2026

FTESË PËR OFERTË

ME OBJEKT: *Ftesë për ofertë për catering për familjet që do jenë pjesë e trajnimeve për prindërimin pozitiv, projekti Familje të Qëndrueshme (RF-SoP) Shkodër*

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjen për fëmijët, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë në familjet e tyre biologjike.

SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri që nga Tetori 2024, në programin Shkodër, ka filluar implemetimin e projektit “Resilient Families – A Step out of Poverty” I cili ka si qëllim të luftojë varfërinë përmes fuqizimit ekonomik të familjeve, ndihmës për zhvillimin e kapaciteteve, mbështetjes psikologjike dhe promovimit të shëndetit dhe edukimit.

Në kuadër të këtij projekti për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e tij, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri shpall kërkesën për shërbim catering të nevojshme për organizimin e trajnimeve me prindër për modulën Programi i Fuqizimit të Familjes në Lokacionin e Shkodrës.

Për ofrimin e këtij shërbimi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri fton kompanitë /subjektet që kanë në fokus të punës së tyre ofrimin e shërbimeve catering **të paraqesin interesin e tyre deri më datë 25.03.2026** duke paraqitur ofertat e tyre financiare dhe dokumentat plotësuese nepermjet postës elektronike në adresën info@soskd.org.al

Dokumentat që duhet të jenë pjesë e ofertës duhet të përmbajnë:

- Kopje të Ekstraktit Historik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit jo më parë se një muaj;
- Kopje NIPT-i;
- Vërtetim nga Tatimet për shlyerje të detyrimeve tatimore (gjeneruar online);
- Ofertën financiare e cila duhet të jetë në monedhën Lekë dhe çmimet duhet të përfshijnë TVSH-në dhe transportin deri në ambientet e SOS Fshatrat të Fëmijëve sipas adresës së shënuar më poshtë;
- Informacion i detajuar mbi menutë e propozuara, ku duhet të propozohen të paktën 3 menu ushqimore. Menutë duhet të përfshijnë një lëng (ujë, lëng frutash etj) dhe një frut ose embëlsirë.

Informacion i përgjithshëm mbi shërbimin e kërkuar:

1. Trajnimete modulit Fuqizimi i Familjes do të zhvillohen në ambientet e Qendrës Komunitare “Xixëllonjat”, pranë ish-shkollës Veterinare Shkodër. Oferta financiare duhet të përfshijë transportin deri në këtë adresë.
2. Trajnimet do të zhvillohen për 12 javë rresht, pra do të jenë në total 12 seanca.
3. Numri i pjesëmarrësve për një seancë do të jetë 27 persona.
4. Trajnimet do të zhvillohen në periudhën Prill – Qershor 2026.

Mënyra e pjesëmarrjes në tender

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj nëpërmjet emailit zyrtar info@soskd.org.al deri më datë 25/03/2026.

Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së procedurës nuk do të pranohet.

Forma e komunikimit në rast se keni pyetje duhet të jetë me shkrim, nëpërmjet formës elektronike email info@soskd.org.al

Përgjigjet e pyetjeve tuaja do ti merrni gjithashtu nëpërmjet formës elektronike info@soskd.org.al

Vlerësimi i ofertave:

Në përputhje me manualin financiar të SOS Fshatrave të Fëmijëve Shqipëri vlerësimi i ofertave do të bëhet bazuar në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, cilësinë dhe larmishmërinë e menuve të paraqitura në raport me ofertën financiare.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.